



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Termet e Referencës

Pergaditja e Video-Storjes

Projekti: ‘Grate rurale dhe fuqizimi i tyre socio-ekonomik ne periudhen e post-pandemise’
Zbatuar nga: Rrjeti i Organizatave per Zhvillim Rural te Kosoves – RROZHRK
Mbështetur nga: Fondi i Grave të Kosovës, me financim nga Zyra e Bashkimit European ne Kosove.

HISTORIKU

Organizata “Rrjeti i Organizatave per Zhvillim Rural te Kosoves – RROZHRK” është themeluar në vitin 2013, e cila parimisht e ka në fokus primar sektorin e zhvillimit rural dhe me të gjitha aspektet tjera që kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm rural përfshirë ekspertize në promovim, adresim, rrjetëzim avokim dhe lobim për politikat agro-rurale, socio-ekonomike, gjinore, mjedisore dhe me aspektet tjera që i kontribuojnë sektorit dhe komunitetit rural. Njëra nga komponentet kryesore të strategjisë së RROZHRK-së është barazia ginore në kontekst rural. Që pothuajse 3 vite në mënyrë proaktive adresojmë nevojat, problemet e grave nga/në zonat rurale në mbarë Kosovën. Në këtë kontekst përmes trajnimeve, punëtorive dhe aktiviteteve avokuese kemi mbështetur angazhimet socio-ekonomike të grave rurale në forma të ndryshme.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Projekti” Gratë rurale dhe fuqizimi i tyre socio-ekonomik në periudhën e post-pandemisë” i mbështetur nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe financuar nga Bashkimi Evropian ka për qëllim Fuqizimin socio-ekonomik të grave rurale përmes ndërjegjësimit institucional mbi sfidat dhe pasojat që situatat emergjente sjellin dhe masat parandaluese e mbështetëse, si dhe informimit të grave mbi mundësitë e mbështetjes institucionale.

Projekti synon të trajtoj dimenzionin e fuqizimit ekonomik të grave përkatësisht grave nga zonat rurale që është kategori që ka fokus strategjik nga ana e RROZHRK-së.

Sfidat që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe social në Kosovë kanë pasur ndikim tek te gjithë shoqeria sidomos me implikimet dhe pasojat e shkaktuara nga pandemia Covid-19.

Një nga kategoritë më të atakuara nga kriza socio-ekonomike post-pandemisë, janë pikërisht gratë me theks të vecantë gratë që jetojnë dhe gravitojnë në zona rurale.

Humbja e vendeve të punës, mungesa e qasjes në pronë e toke bujqësore, dhuna me bazë gjinore dhe problemet tjera të natyrës socio-ekonomike janë vështirësi e sfida të cilat i kanë shoqëruar dhe shoqërojnë gratë nga zonat rurale anembanë vendit.

Pra, projekt propozimi yne synon që tv adresoj aspektin e fuqizimit ekonomik të grave nga zonat rurale si aspekt i goditur rëndë nga pasojat e pandemisë Covid-19. Për zbatimin e këtij projekti RROZHRK kërkon të punësoj një Ekspert/e, i/e cili/a do jetë pergjegjës/e për përmbledhjen e politikave të cilat do të adresohen në takimet avokuese me institucionet kompetente.

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:





PËRGJEGJËSITË

Kompania do të angazhohet për realizimin e video-storjes si produkt i projektit konform kërkesave dhe specifikave të projektit.

Qellimi i realizimit të video-storjes është promovimi i storjeve dhe shembujve të suksesshem të grave fermere dhe grave aktive në bujqësi e në sektorin e biznesit kryesisht në zonat rurale dhe jo vetem.

DETYRAT

Disa nga përgjegjësitë për të cilat do të angazhohet Eksperti/ja përfshijnë:

- Intervistimi i 4 grave (minimumi) nga zonat rurale me fokus të vecante të grate fermere dhe grate aktive në biznese;
- Pergaditja e videostorjes në mënyrë me profesionale sipas standardeve të kërkuara
- Video-storja minimalisht duhet të zgjas 5 minuta;
- Kompania duhet të bashkepunoj ngushtë me ekipin e RROZHRK sa i përket përmbajtjes së video-storjes;
- Kompania duhet ta finalizoj videon dhe ta transferoj në CD për qëllime të përdorimit të metutjeshem;
- Kompania duhet t'a finalizoj videon në gjuhën shqipe;

KUALIFIKIMET DHE KËRKESAT E EKSPERTIT/ËS

Kompania e përzgjedhur duhet të demonstrojë që:

- I takon profilit / është studio e realizimit të produkteve (videove)
- Të paktën 3 vite përvojë /aktivitet si kompani;
- Eksperiencë të mëparshme në realizimin e videove të natyrës së tillë;
- Përvoja në punën me komunitetin ndërkombëtar të donatorëve do të konsiderohet si një aset.
- Përvoja e mëparshme në punë me RROZHRK do të konsiderohet si një aset i fortë;

Ofruesi i kontraktuar do të jetë i detyruar të kryejë kompetencat e mëposhtme:

- Demonstron integritet duke aplikuar vlerat dhe parimet etike të RROZHRK-së.
- Të demonstrojnë kompetencë profesionale dhe të ndërgjegjshme dhe efikase në përmbushjen e angazhimeve.
- Respektimi i afateve dhe arritja e rezultateve.
- Shfaq ndjeshmërinë dhe përshtatshmërinë kulturore, gjinore, etnike, fetare dhe moshore

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:





Financuar nga
Bashkimi Evropian

AFATET KOHORE

Shpallja e pozitës	05.12.2023
Afati i fundit për aplikimet	15.12.2023
Zgjedhja e Kompanise	20.12.2023
Nënshkrimi i kontratës dhe takimi informativ	22.12.2023
Drafti i parë i dorëzimit të materialit	Mbetet të konfirmohet
Materiali final	Mbetet të konfirmohet

KOHËZGJATJA

Kompania do të angazhohet për periudhën kohore Dhjetor 2023 – Janar 2024. Data indikative për fillimin e zbatimit të detyrave është 23 Dhjetori 2023.

DORËZIMI I OFERTAVE

Aplikimi duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

- Dokumentacioni i biznesit (certifikata e regjistrimit)
- Oferta financiare duhet të ofrohet në Euro, pa TVSH.
- Metodologji e shkurtër lidhur me realizimin e videos.

Dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen deri më 15 Dhjetor 2023, në orën 17:00 në e-mail apply.nordk@gmail.com (cc në prek.nordk@gmail.com) ose edhe fizikisht në adresën zyrtare të RROZHRK-se: Rruga Rr. UCK, p.n. 21000 Rahovec, Kosove.

6. Vlerësimi i ofertave

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh dhe nuk do t'i nënshtrohen vlerësimit të mëtejshëm. Ofertat do të vlerësohen nga një Komision prej tre personave. Vlerësimi i ofertave do të bazohet në "parimin më të mirë të vlerës për paranë" duke përdorur një metodë të ponderimit të pikëve për të vlerësuar kombinimin e kualifikimit të aplikantëve (70%) dhe propozimit financiar (30%)

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

